DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-118/4
Data Datum Date 03.02.2014

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë,29.01.2014
Nr. 0204-118

**PËR:** Agim Bahtiri, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Bislim Imeri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

**LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS, Nr. 02/06-208/5,** të pranuar me datën 23.01.2014.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit nr. 02/06-208/5, të datës 16.01.2014, të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, konstaton se:

- Vendimi Nr. 02/06-208/5, për formimin e Komitetit për Komunitet , është në kundërshtim me nenin 53.1 të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale.

- Me rastin e formimit të Komitetit për Komunitete anëtarët e këtij komiteti duhet të përbëjnë shumicën, nga radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës. Përfaqësuesit e komunitetit jo shumicë në komunë përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit për komunitete. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ***kërkon*** nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës, që të ndërmarrin veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëj rishqyrtimin e Vendimin nr. 02/06-208/5, të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Udhëheq të Departamenteve dhe Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-118/4
-VI-
Data Datum Date 03.02.2014

# Republika e Kosovës
# Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum,29.01.2014
br. 0204-118

**Za:** Agim Bahtiri, Gradonačelnik opštine Mitrovica
Bislim Imeri , Predsedavajući Skupštine opštine Mitrovica

**Predmet: Zahtev o ponovnom razmatranju odluke opštine Mitrovica , br. 02/06-208/5,** primljeno dana 23.01.2014.

Poštovani,

Ministartvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokanoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva nakon razmatranja zakonitosti odluke br. 02/06-208/5, dana 16.01.2014, od strane Skupštine opštine Mitrovica ,konstatuje da ,

- Odluka br. 02/06-208/5, o formiranju odbora za zajednice , je u suprotnosti sa članom 53.1 zakona br. 03/z-040, o loklanoj samoupravi .

- Povodom formiranja odbora za zajednice članovi ovog odbora treba uključiti u redovima prosto-većinu članova Skupštine opštine ,ostali članovi treba biti predstavnici zajednica. Predstavnici ne većinske zajednice u opštini čine većinu članova odbora za zajednice. Svaka zajednica koj zivi u opstini predstavlja najmanje od jednok prestavnika zajednice.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osnovu člana 82 tačka 2 zakona o loklanoj samoupravi,***traži*** od strane Skupštine opštine , Mitrovica da preduzme konkretne mere da odluka br. 02/06-208/5,Skupštine opštine Mitrovica u roku od 30 dana od dana prijema zahteva izvrši ponovno razmatranje akta.

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja i kancelarija*
*Arhivi MALS-a*

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

**KUVENDI I KOMUNËS**
**Nr. 02/06-208/5 dt. 16.01.2014**
**Mitrovicë**

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 4, nenin 40, paragrafi 2, alineja e, nenin 51, paragrafi 1, dhe nenin 53 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2009). Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 16.01.2014 pasi shqyrtoi Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, sjellë këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e Komitetit për Komunitete**

1. Me këtë Vendim formohet Komiteti për Komunitete në përbërje:
   1.1 Anëtar nga radhët e PDK-së.
   1.2 Anëtar nga radhët e PDK-së.
   1.3 Nuhi Kalludra.
   1.4 Anëtar nga radhët e AKR-së.
   1.5 Anëtar nga radhët e VV-së.
   1.6 Anëtar nga komunitetet
   1.7 Anëtar nga komunitetet
   1.8 Anëtar nga komunitetet
   1.9 Anëtar nga komunitetet

   Obligohen grupet e anëtarëve të Kuvendit të PDK-së, AKR-së, VV-së dhe anëtarët e komuniteteve, që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës të japin emrat e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, me qëllim të kompletimit të përbërjes.
2. Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës, si dhe ushtron përgjegjësitë e parapara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe rregulloret komunale.
3. Komiteti për Komunitete do të promovojë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe do të shqyrtojë drejtë çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, do t'ia paraqesë çështjen Kryetarit të Komunës dhe do të bëjë rekomandimin e saj në Kuvendin e Komunës.
4. Anëtarët e Komitetit për Komunitete të emëruar me pikën 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të Kuvendit të Komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bislim IMERI**

Dorëzohet:
1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës